



| | | | |
|--|--------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prudato Received/Deliverty | 05.07.2022 | 2 | viti god year |
| Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit | Hi Prot Ist Prot Prof No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SADM&CL | 3930 | 2022 | 1/4 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.476/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Kocanëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.476/2022 të datës 24.05.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted] në çështjen juridike "kontestim konkursi", kundër organit të punësimit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 04.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.476/2022 e datës 24.05.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale sipas njoftimit datës 14.02.2022 ka publikuar konkursin e jashtëm për grupin „Specialist Ligjor” për pozitën “Zyrtar Ligjor 2” në Departamentin Ligjor, me numër reference RN00008397 për afatin për aplikim nga data 07.03.2022 deri me datë 21.03.2022, në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi [redacted] i cili ka marrë pjesë në të gjitha fazat e zhvillimit të procedurës së rekrutimit.

Me datë 10.05.2022, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, gjegjësisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka publikuar njoftimin për përfundimin e procedurës së vlerësimit dhe shpalljen e rezultateve me fitues për pozitën “Zyrtar Ligjor 2” në Departamentin Ligjor, me numër reference RN00008397.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 10.05.2022 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, gjegjësisht Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, me datë 24.05.2022 parashtron ankesë me numër të protokollit 3007/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore që procedura e rekrutimit për grupin „Specialist Ligjor” për pozitën “Zyrtar Ligjor 2” në Departamentin Ligjor, me numër reference RN00008397 e zhvilluar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është zhvilluar në kushte të pabarabarta pasi që Komisioni i Pranimit nuk i ka bërë vlerësimin e drejtë dhe objektiv si në kualifikim, përvojë profesionale në test me shkrim dhe në intervistë me gojë, andaj propozon që ti aprovohet ankesa dhe të ndryshohet rezultati përfundimtar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 27.05.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ndërsa Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me datë më datë 01.06.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/105.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 24.05.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 10.05.2022 për përzgjedhje përfundimtare; Vendimi i datës 08.02.2022 për emërimin e Komisionit Vlerësues; e-mail i datës 09.11.2021, Akt emërimet e anëtarëve të Komisionit Vlerësues; Lista e pikantëve; Aplikacioni i kandidatës [redacted] me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacioni i ankuesit [redacted] me dokumentacionin e bashkangjitur; Ankesa e ankuesit e parashtruar në organin e punësimit e datës 02.04.2022 për mos përfshirje në listën e ngushtë; e-mail i datave 29.03.2022, 01.04.2022; Vendimi i datës 04.04.2022; Njoftimi i datës 06.04.2022; Rezultatet e testimit elektronik; Testi individual; e-mail i datave 30.05.2022, 04.05.2022, 08.04.2022, 01.04.2022, Vlerësimi i jetëshkrimit; Konkursi i datës 07.03.2022 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e pa lejuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në shkresat e lëndës të dorëzuara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankuesi [redacted] me datë 24.05.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 3007/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër me njoftimit të datës 10.05.2022 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, gjegjësisht Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, me të cilën janë shpallur rezultatet përfundimtare për pozitën “Zyrtar Ligjor 2”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: “Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashitrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore “Këshilli”) . 2. Ankesa në Këshill parashitrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet”.

Kolegji në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesi ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit për grupin „Specialist Ligjor” për pozitën “Zyrtar Ligjor 2” në Departamentin Ligjor, me numër reference RN00008397” të shpallur nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ndërsa i njëjti i pakënaqur me njoftimin e datës 10.05.2022 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për përfundimin e procedurës së vlerësimit dhe shpalljen e rezultateve me fitues për pozitën “Zyrtar Ligjor 2” në Departamentin Ligjor, me numër reference RN00008397, ka parashtruar ankesë me datë 24.05.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj Kolegji në mbështetje të nenit 31 paragrafi 3 dhe 4 nën paragrafi 4.2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: “3. Në rastin e pakënaqësisë ndaj procedurës apo rezultatit të konkurimit, pavarësisht nga faza me të cilin kandidati është i pakënaqur, ankesa parashtrohet ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje. 4. Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje” ka konstatuar se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 24.05.2022 është e palejueshme pasi që i njëjti nuk ka parashtruar ankesë kundër aktit përfundimtar, respektivisht Njoftimit të datës 10.05.2022 në të cilin konstatohet se kandidatja është përzgjedhur si kandidat e suksesshme, siç përcaktohet me paragrafin 6 të nenit 25 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës: “Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje” ndërlidhur me paragrafin 1 dhe 5 të nenit 25 të së njëjtës rregullore ku parashihet se: “1. Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj; 5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual”.

Po ashtu, Kolegji në bazë të dëshmive të ofruara nga organi i punësimit ka gjetur se ankuesi lidhur me përfundimin e procedurës së vlerësimit dhe shpalljen e rezultateve me fitues për pozitën “Zyrtar Ligjor 2” në Departamentin Ligjor ka qenë i njoftuar edhe me e-mailin e datës 11.05.2022 dhe meqenëse ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi të provueshme se i njëjti pavarësisht parashtrimin të ankesës në Këshill të ketë parashtruar ankesë të brendshme kundër vlerësimit përfundimtar të kandidatëve respektivisht kundër njoftimit të datës 10.05.2022, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit është e palejueshme ngase nuk ka shteruar procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit, ashtu siç përcaktohet në nenin 25 paragrafin 5 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, respektivisht ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 16 paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet

përcaktohet se: "Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të Kryetares së Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.4762022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale;
- Udhëheqëses së Personelit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.